



VENDIM

Nr. 75 Datë 08.06.2015

PËR

MIRATIMIN E MODIFIKIMIT TË LICENSËS ME NR. 138, SERIA PV11K PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET E “PELLGUT TË OKSHTUNIT”, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 31.489 MW, TË SHOQËRISË “DITEKO” SH.P.K., TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 114 DATË 16.11.2011

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; pikave 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike Nr. 138, Seria PV11K”; neneve 13; 14 pika 2; 15 pikat 1, 2/b, 3 dhe 4; të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.06.2015, mbasi lexoi relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "DITEKO" sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat ligjore të parashikuara nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”** : Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës, i plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 15, pika 4, gërma “b”: Është paraqitur vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit, të cilat shkrehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e liçensës.

- Është paraqitur projekti i ri, i miratuar nga MEI me shkresën nr. 131/8 Prot, datë 08.07.2014, për një shfrytëzim optimal të prurjeve të lumit Zalli i Okshtunit, ku janë bërë disa ndryshime në skemën e shfrytëzimit të kaskadës e cila tashmë përbëhet nga 7 Hec-e dhe jo nga 11 Hec-e.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Modifikimin e licensës së shoqërisë “DITEKO” sh.p.k. me nr. 138, Seria PV11K, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec-et e ”Pellgut të Okshunit” me fuqi totale të instaluar 31.489 MW, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr 141 date 16.11.2011.
2. Fuqia e instaluar e Hec-eve të ”Pellgut të Okshunit”, nga 31.489 MW të bëhet 33.28 MW, sipas emërtimeve dhe fuqive si më poshtë : Hec “Borove” me fuqi të instaluar 1.92 MW, Hec “Zabzun” me fuqi të instaluar 0.3 MW, Hec “Sebisht + Prodan 1” me fuqi të instaluar 3.8 MW, Hec “Prodan 2” me fuqi të instaluar 1 MW, Hec “Okshun Ekologjik” me fuqi të instaluar 0.45 MW, Hec “Okshun + Ternove + Lubalesh 1” me fuqi të instaluar 14.95 MW dhe Hec “Lubalesh 2 + Gjorice” me fuqi të instaluar 10.86 MW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI